LIGJ
Nr.10 068, datë 2.2.2009

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, bëhen ky ndryshim dhe kjo shtesë:

Neni 1

Në nenin 19 "Furnizimet e përjashtuara", pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"l. Furnizimi është një furnizim i përjashtuar nëse ai përcaktohet në nenet 20 deri në 25 dhe në nenet 25.1, 25.2, 25.3, 25.5, 25.6, 25.7, 25.8 dhe 26.1 të këtij ligji.".

Neni 2

Pas nenit 25.7 shtohet neni 25.8 me këtë përmbajtje:

"Neni 25.8

Furnizimi i kartave të identitetit është furnizim i përjashtuar.".

Neni 3

Neni 26/1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 26/1

Është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja:

a) importimi përfundimtar i të gjitha mallrave prej një personi të tatueshëm, kur furnizimi i tyre në të gjitha rrethanat, brenda vendit, është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Kjo shkronjë nuk zbatohet për furnizimin në import të shtypshkrimeve dhe librave të çdo lloji;

b) importimi i mallrave të vendosura në regjimin e tranzitit;

c) importimi i mallrave të deklaruara për të qenë nën regjimin e lejimit të përkohshëm dhe atë të përpunimit aktiv;

ç) importimi i mallrave dhe i shërbimeve që lidhen me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët që punojnë për këto operacione. Kontraktorët dhe nënkontraktorët vërtetohen si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

"Operacione hidrokarbure", për efekt të këtij paragrafi, ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet", të ndryshuar;

d) importimi i kafshëve të gjalla të racës, të dhuruara nga donatorë të ndryshëm;

dh) importimi i mallrave nga NATO-ja dhe organizmat e saj, në kuadër të operacioneve, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare;

e) importimi i materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura, të dhuruara nga vendet e Aleancës së NATO-s dhe ato partnere;

ë) importimi i mjeteve, të cilat ndihmojnë në integrimin në jetë të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përfshirë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre;

f) importimi i anijeve, sipas nënkrerëve 8901 20, 8901 30, 8901 90, 8902 00 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6067, datë 20.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi